



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

---

Numri i lëndës: 2021:144852

Datë: 14.11.2022

Numri i dokumentit: 03641800

C.nr.1007/21

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, me Gjyqtaren Mirjeta Shala dhe bashkëpunëtoren profesionale Kaltrina Halilaj, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësve A.B, M.R, A.K, H.Z dhe A.B, që të gjithë nga Gjakova, të cilët me autorizim i përfaqëson i autorizuari Arben Biblekaj, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës-DKA, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, shpenzimeve të transportit dhe kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, vlera e kontestit 6,622.45.-€, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të mbajtur në prezencën e të autorizuarit të paditësve dhe në mungesë të autorizuarit të të paditurës, me datë 02 Nëntor 2022 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditësve A.B, M.R, A.K, H.Z dhe A.B dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - DKA, që :

- ◇ Paditëses A.B të ia paguajë shumën e përgjithshme prej 397.70.-€ (treqind e nëntëdhjetë e shtatë euro e shtatëdhjetë cent) dhe atë:
  - në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për periudhën kohore nga 01.02.2021 e deri me datë 02.07.2021, respektivisht për 97 ditë të pranisë në punë, shumën prej 194.00.-€,
  - në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit për periudhën kohore nga data 01.02.2021 e deri me datë 02.07.2021, respektivisht për 97 ditë të pranisë në punë, shumën prej 203.70.-€.
  
- ◇ Paditëses M.R të ia paguajë shumën e përgjithshme prej 906.75.€ (nëntëqind e gjashtë euro e shtatëdhjetë e pesë cent) dhe atë:

- në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për periudhën kohore nga 14.09.2020 e deri me datë 25.03.2022, respektivisht për 315 ditë të pranisë në punë, shumën prej 630.00.-€,
  - në emër të kompensimit për të ardhurat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, në vlerë prej 27% të pagës bazë për 5 muaj të licencimit dhe atë për periudhën kohore nga data 01.09.2020 deri me datë 31.01.2021 (për çdo muaj shumën nga 55.35 euro) të ia paguajë shumën prej 276.75.-€
- ◇ Paditëses A.K të ia paguajë shumën e përgjithshme prej 2,928.00.-€ (dymijë e nëntëqind e njëzet e tetë euro) dhe atë:
- në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për periudhën kohore nga 14.09.2020 e deri me datë 24.06.2022, respektivisht për 357 ditë të pranisë në punë, shumën prej 714.00.-€,
  - në emër të kompensimit për të ardhurat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, në vlerë prej 27% të pagës bazë për 40 muaj të licencimit dhe atë për periudhën kohore nga data 08.10.2017 deri me datë 31.01.2021 (për çdo muaj shumën nga 55.35 euro) të ia paguajë shumën prej 2,214.00.-€
- ◇ Paditësit H.Z të ia paguajë shumën e përgjithshme prej 1,710.00.-€ (njëmijë e shtatëqind e dhjetë euro) dhe atë:
- në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për periudhën kohore nga 14.09.2020 e deri me datë 19.02.2021, respektivisht për 76 ditë të pranisë në punë, shumën prej 152.00.-€,
  - në emër të kompensimit për të ardhurat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, në vlerë prej 19% të pagës bazë për 40 muaj të licencimit dhe atë për periudhën kohore nga data 08.10.2017 deri me datë 31.01.2021 (për çdo muaj shumën nga 38.95 euro) të ia paguajë shumën prej 1,558.00.-€
- ◇ Paditëses A.B në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për periudhën kohore nga 14.09.2020 e deri me datë 24.06.2022, respektivisht për 340 ditë të pranisë në punë, shumën prej 680.00.-€ (gjashtëqind e tetëdhjetë euro).

Të gjitha shumat e lartcekura, detyrohet e paditura që të i paguajë me kamatë ligjore prej 8% në vit për secilin paditës, e cila do të llogaritet nga data 05.07.2021 (data e paraqitjes së padisë), e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura që në emër të pagesës për shpenzimet e procedurës, paditësve të iu paguajë shumën prej 1,182.00.-€, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

III. Konstatohet e tërhequr padia e paditëseve A.B dhe A.B, sa i përket kërkesës lidhur me kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit.

### A r s y e t i m

Paditësit A.B, M.R, A.K, H.Z dhe A.B, që të gjithë nga Gjakova, përmes të autorizuarve të tyre Fitim Gashi, avokat në Prishtinë dhe Arben Biblekaj, avokat në Prishtinë, në këtë gjykatë me datë 05.07.2021, kanë parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë, shpenzimet e transportit dhe kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, duke theksuar se të njëjtit janë punëtorë të arsimit në SHFMU “Selman Riza” në Gjakovë. Meqenëse e paditura nuk iu ka paguar të njëjtëve shujtën për ushqim ditor, shpenzimet e udhëtimit si dhe kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, atëherë të njëjtit kanë paraqitur padi me të cilat kanë kërkuar shumat përkatëse. I autorizuari i paditësve me parashtrësën e datës 05.10.2022 ka bërë precizimin e kërkesëpadiës në aspektin objektiv, duke e zvogëluar të njëjtën, po ashtu në mungesë të provave është tërhequr nga padia e paditësve A.B dhe A.B, sa i përket kërkesës lidhur me kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit.

Në seancën e shqyrtimit kryesor i autorizuari i paditësve ka deklaruar se: mbesim pranë padisë dhe kërkesëpadiës duke e precizuar të njëjtën përkatësisht zvogëluar kërkesën në aspektin objektiv për secilin paditës sa i përket kërkesës për kualifikimin arsimor. Pas administrimit të provave u vërtetua kërkesëpadia si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia e saj, andaj i propozoi kësaj Gjykate që të nxjerrë Aktgjykim me të cilin e aprovon kërkesëpadinë e paditësve në shumat e precizuara sipas parashtrësës të dorëzuar drejtpërdrejtë në seancë në të cilën është zvogëluar pagesa e paditësve, të gjitha me kamatë ligjore prej 8% nga data e dorëzimit të padisë e deri në pagesën definitive.

I ka kërkuar shpenzimet e procedurës dhe atë : për përpilimin e padisë shumën prej 312.00.-€, për taksë shumën prej 20.00.-€, për parashtrësën e përpiluar me datë 05.10.2022 dhe e dorëzuar në seancën e datës 10.10.2022, në shumën prej 312.00.-€, për dy seanca të mbajtura nga 405.00.-€, që në total arrin shumën prej 1,454.00.-€.

Gjyqtarja e çështjes në seancën e datës 02.11.2022 ka detyruar të autorizuarin e paditësve që në afat prej 3 ditësh të bëjë pagesën e diferencës së taksës dhe atë në vlerë prej 40.00 euro, nën kërcënim të pasojave ligjore, ashtu që i autorizuari i paditësve me parashtrësën e datës 02.11.2022 ka njoftuar gjykatën se e ka paguar diferencën në emër të taksës gjyqësore në vlerë prej 40.00 euro, ku ia ka bashkangjitur edhe Urdhërpagesën në emër të diferencës së taksës gjyqësore për lëndën C.nr.1007/21, andaj ka kërkuar që si shpenzim i procedurës të i paguhet edhe kjo shumë.

Aktvendimin për përgjigje në padi të datës 10.08.2021 së bashku me padinë dhe provat, gjykata i'a ka dërguar të paditurës, të cilat e njëjta i ka pranuar me datë 11.08.2021 (që vërtetohet nga fletëkthesa e cila gjendet në shkresat e lëndës), mirëpo e njëjta nuk ka parashtruar përgjigje në padi.

Gjykata në kuptim të nenit 423 par.4 të LPK-së, shqyrtimin kryesor e mbajti në mungesë të paditurës të ftuar në mënyrë të rregullt.

#### *Gjendja faktike e vërtetuar*

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor-publik ka administruar provat si në vijim : Kontrata e punës për paditësen A.B e lëshuar nga Komuna e Gjakovë – DKA, në versionin e fotokopjuar, Diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit “Fehmi Agani” në Gjakovë, në versionin e fotokopjuar, Vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “Selman Riza” në Gjakovë, me numër të protokollit 568/22 i datës 12.09.2022, Certifikata e vendbanimit me numër B10321971, Vërtetimi i lëshuar nga Shoqata e Transportit të Udhëtarëve, Kopja e letërnjoftimit për paditësen A.B, Kontrata e punës për paditësen M.R e lëshuar nga Komuna e Gjakovës – DKA, në versionin e fotokopjuar me numër të kontratës 99/2019, Diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Edukimit në Prishtinë, në versionin e fotokopjuar, Vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “Selman Riza” në Gjakovë, me numër të protokollit 571/22 i datës 12.09.2022, Licenca e mësimdhënësës me numër të protokollit 1026580, Lista e pagës për muajin Gusht 2022, Kopja e letërnjoftimit për paditësen M.R, Kontrata e punës për paditësen A.K e lëshuar nga Komuna e Gjakovës – DKA, në versionin e fotokopjuar me numër të kontratës 46/2015, Diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, “Hasan Prishtina”- Fakulteti i Edukimit qendra në Prizren, në versionin e fotokopjuar, Vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “Selman Riza” në Gjakovë, me numër të protokollit 567/22 i datës 09.09.2022, Licenca e mësimdhënësit me numër 100022553, Lista e pagës për muajin Gusht 2022, Kopja e letërnjoftimit për paditësen A.K, Kontrata e punës për paditësin H.Z e lëshuar nga Komuna e Gjakovë – DKA, në versionin e fotokopjuar me numër të kontratës 39/15, Diploma e lëshuar nga Universitetit i Prishtinës Fakulteti i Edukimit (Shkolla e lartë pedagogjike) në Prizren, Vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “Selman Riza” në Gjakovë, me numër të protokollit 368/21 i datës 23.04.2021, Licenca e mësimdhënësit me numër 100008915, Vendimi 04.Nr. 30 i datës 05.02.2021, Lista e pagës për muajin Janar 2021, Kopja letërnjoftimit për paditësin H.Z, Kontrata e punës për paditësen A.B e lëshuar nga Komuna e Gjakovës – DKA, në versionin e fotokopjuar, Vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “Selman Riza” në Gjakovë, me numër të protokollit 564/22 i datës 09.09.2022, Kopja e letërnjoftimit për paditësen A.B.

Gjykata pasi bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), erdhi në përfundim se duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga provat e administruara gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

- Për paditësen A.B

Nga Kontrata e punës për paditësen e lëshuar nga Komuna e Gjakovës – DKA, në versionin e fotokopjuar, paditësja e lartcekur është e punësuar tek e paditura, si mësimdhënëse e mësimit klasor dhe në këtë institucion arsimor në periudhën kohore prej datës 01.02.2021 deri me datë 02.07.2021 ka punuar gjithsej 97 ditë pune, bazuar në Vërtetimin e lëshuar nga SHFMU “Selman Riza” në Gjakovë, me numër të protokollit 568/22 të datës 12.09.2022. Paditësja bazuar në Diplomën e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit “Fehmi Agani” në Gjakovë, në versionin e fotokopjuar, ka diplomuar me datë 19.03.2019 dhe ka marrë kualifikimin Bachelor i edukimit fillor. Sipas Certifikatës së vendbanimit me numër B10321971, e njëjta ka vendbanimit në fshatin Devë, Komuna e Gjakovës dhe për relacionin Devë – Piskotë paguan biletë udhëtimi në vlerë prek 1.50 euro një drejtim, bazuar në Vërtetimin e lëshuar nga Shoqata e Transportit të Udhëtarëve. Nga Kopja e letërnjoftimit për paditësen A.B, gjykata ka vërtetuar identitetin e saj.

- Për paditësen M.R

Nga Kontrata e punës për paditësen të lëshuar nga Komuna e Gjakovës – DKA, në versionin e fotokopjuar me numër të kontratës 99/2019, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja e lartcekur është e punësuar tek e paditura, si mësimdhënëse e programit fillor - klasor dhe në këtë institucion arsimor në periudhën kohore prej datës 14.09.2020 deri me datë 25.03.2022 ka punuar gjithsej 315 ditë pune, bazuar në Vërtetimin e lëshuar nga SHFMU “Selman Riza” në Gjakovë, me numër të protokollit 571/22 të datës 12.09.2022. Nga Lista e pagës për muajin Gusht 2022, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja, pagën bazë e ka në lartësi prej 421.00 euro dhe të njëjtës i është paguar shtesa në emër të kualifikimit Fakultet në shumën prej 58.32 euro, meqenëse paditësja bazuar në Diplomën e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit në Prishtinë, në versionin e fotokopjuar, ka diplomuar me datë 08.10.2014 dhe ka marrë kualifikimin Bachelor i programit fillor, si dhe ka licencë të rregullt dhe të karrierës, bazuar në Licencën e mësimdhënëses me numër të protokollit 1026580. Nga Kopja e letërnjoftimit për paditësen M.R gjykata ka vërtetuar identitetin e saj.

- Për paditësen A.K

Nga Kontrata e punës për paditësen të lëshuar nga Komuna e Gjakovës – DKA, në versionin e fotokopjuar me numër të kontratës 46/2015, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja e lartcekur është e punësuar tek e paditura, si mësimdhënëse e gjuhës shqipe dhe në këtë institucion arsimor në periudhën kohore prej datës 14.09.2020 deri me datë 24.06.2022 ka punuar gjithsej 357 ditë pune, bazuar në Vërtetimin e lëshuar nga SHFMU “Selman Riza” në Gjakovë, me numër të protokollit 567/22 të datës 09.09.2022. Nga Lista e pagës për muajin Gusht 2022, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja, pagën bazë e ka në lartësi prej 421.00 euro dhe të njëjtës i është paguar shtesa në emër të kualifikimit Fakultet në shumën prej 58.32 euro, meqenëse paditësja bazuar në Diplomën e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, “Hasan Prishtina”-Fakulteti i Edukimit qendra në Prizren, në versionin e fotokopjuar, ka diplomuar me datë

16.06.2017 dhe ka marrë kualifikimin bachelor i gjuhës dhe letërsisë shqipe, si dhe ka licencë të rregullt dhe të karrierës, bazuar në Licencën e mësimdhënësit me numër 100022553. Nga Kopja e letërnjoftimit për paditësen A.K gjykata ka vërtetuar identitetin e saj.

- Për paditësin H.Z

Nga Kontrata e punës për paditësin të lëshuar nga Komuna e Gjakovës – DKA, në versionin e fotokopjuar me numër të kontratës 39/2015, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi i lartcekur është i punësuar tek e paditura, si mësimdhënës i gjuhës angleze dhe në këtë institucion arsimor në periudhën kohore prej datës 14.09.2020 deri me datë 19.02.2021 ka punuar gjithsej 76 ditë pune, bazuar në Vërtetimin e lëshuar nga SHFMU “Selman Riza” në Gjakovë, me numër të protokollit 368/21 të datës 23.04.2021. Të njëjtit me Vendimin 04.Nr. 30 të datës 05.02.2021 i është ndërprerë kontrata e punës sipas fuqisë ligjore, pasi ka mbushur moshën e pensionimit. Nga Lista e pagës për muajin Janar 2021, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi, pagën bazë e ka në lartësi prej 421.00 euro dhe të njëjtit i është paguar shtesa në emër të kualifikimit SHLP në shumën prej 41.04 euro, meqenëse paditësi bazuar në Diplomën e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti Edukimit – Shkolla e Lartë Pedagogjike në Prizren, në versionin e fotokopjuar, ka diplomuar me datë 09.04.1994 dhe ka marrë kualifikimin arsimtar i gjuhës dhe letërsisë angleze, si dhe ka licencë të rregullt dhe të karrierës, bazuar në Licencën e mësimdhënësit me numër 100008915. Nga Kopja e letërnjoftimit për paditësin H.Z gjykata ka vërtetuar identitetin e tij.

- Për paditësen A.B

Nga Kontrata e punës për paditësen të lëshuar nga Komuna e Gjakovës – DKA, në versionin e fotokopjuar, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja e lartcekur është e punësuar tek e paditura, si punëtoare tekniko-shërbyese dhe në këtë institucion arsimor në periudhën kohore prej datës 14.09.2020 deri me datë 24.06.2022 ka punuar gjithsej 340 ditë pune, bazuar në Vërtetimin e lëshuar nga SHFMU “Selman Riza” në Gjakovë, me numër të protokollit 564/22 të datës 09.09.2022. Nga Kopja e letërnjoftimit për paditësen A.B gjykata ka vërtetuar identitetin e saj.

*Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës sa i përket kompensimit lidhur me shpenzimet e ushqimit*

Me nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit me nr. 01B-2056 e datës 18.04.2017 dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovës 01/B e cila ka hyrë në fuqi me datën 22.01.2021, në mënyrë identike parashihet se “*Të punësuarve u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro, për të punësuarit që kane marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore.* Nga provat e administruara si më lartë, gjykata gjeti se paditësit janë të punësuar te e paditura, përkatësisht në shkollën “Selman Riza” në Gjakovë, ashtu që në periudhat kohore të lartcekura, paditësja A.B ka realizuar gjithsej 97 ditë pune, paditësja M.R ka realizuar gjithsej 315 ditë pune, paditësja A.K ka realizuar gjithsej 357 ditë

pune, paditësi H.Z ka realizuar gjithsej 76 ditë pune dhe paditësja A.B ka realizuar gjithsej 340 ditë pune, e krejt këto të vërtetuara nga vërtetimet e lartcekura të lëshuara nga shkolla “Selman Riza” në Gjakovë.

Duke u nisur nga fakti se e paditura, paditësve nuk iu ka paguar shpenzimet e ushqimit të parapara me dispozita ligjore të lartcekura, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është e themeltë, andaj në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit bëri përlllogaritjen në atë mënyrë që e ditët e kaluara në punë të paditësve i ka shumëzuar me 2, andaj edhe iu njohi paditësve shumat si në pikën I të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

*Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës sa i përket kompensimit për të ardhurat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit*

Me nenin 7 par.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, parashihet që “me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi dhe mbi bazën e kualifikimit” [1.2] “Mësimdhënës me shkollë të lartë pedagogjike dy vjeçare 19% të pagës bazë”, [1.3]. “Mësimdhënës me diplomë fakulteti tri dhe katër vjeçar 27% e pagës bazë”. Nga provat e administruara si më lartë, gjykata gjeti se paditëset M.R dhe A.K kanë diplomë fakulteti ndërsa paditësi H.Z ka diplomë të shkollës së lartë pedagogjike, rrethana këto të vërtetuara nga Diplomat përkatëse të lartcekura. Po ashtu, këta paditës kanë licenca të rregullta dhe lloj të licencës të karrierës. Ndërsa nga lista e pagave për secilin paditës, gjykata ka vërtetuar se të njëjtit realizojnë pagë bazë në vlerë prej 421 euro, si dhe gjykata ka vërtetuar faktin se paditëseve M.R dhe A.K iu është paguar shuma prej 58.32 euro në emër të kualifikimit fakultet, ndërsa paditësit H.Z shuma prej 41.04 euro në emër të kualifikimit SHLP. Në përputhje me nenin 7 pika 1.3 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, paditëseve M.R dhe A.K iu takon e drejta e kompensimit në lartësi prej 27% të pagës bazë, ndërsa në përputhje me nenin 7 pika 1.2 të KKAK-së, paditësit H.Z i takon e drejta e kompensimit në lartësi prej 19% të pagës bazë. Në rastin konkret gjykata vendosi duke përlllogaritur në atë mënyrë që për paditësen M.R për 5 muaj, ndërsa për paditësit A.K dhe H.Z për secilin për 40 muaj të punës, i ka shumëzuar me pjesën e mbetur përkatëse nga shtesat lidhur me kualifikimin përkatësisht, duke iu njohur shumat si në pikën I dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes për të gjitha kërkesat ka marrë parasysh edhe nenin 90 paragrafi 5 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, me të cilin parashihet se: “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”. Sipas neneve të lartë cituara të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë detyrimi i punëdhënësit në rastin konkret i të paditurës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe kompensimit për të ardhurat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, e nënshkruar nga Ministria e Arsimit dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e cila prodhon efekt juridik ndaj punëdhënëses të cilët kanë të punësuar punëtorët që të drejtat e tyre burojnë nga ajo kontratë, në rastin konkret, nga gjendja faktike e vërtetuar sipas kontratave të punës për paditësit, gjykatës i rezultoi se e

paditura është punëdhënëse e paditëseve dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga ato kontrata.

Sipas nenit 8 par. 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës (Ligji nr. 04/L – 077), i publikuar në “Gazetën Zyrtare” të Republikës së Kosovës, nr. 16/2012, datë 19.06.2012 (i cili është në implementim nga data 20.12.2012, është paraparë se: “*Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij*”. Për më tepër dispozita e nenit 245 par. 1 të LMD-së, ka paraparë se: “*Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij*”, prej nga rezulton se debitori, përkatësisht e paditura në rastin konkret është e detyruar që kreditorëve, përkatësisht këtu paditëseve në rastin konkret, të iu paguajë vlerën e kërkesëpadisë si dhe shpenzimet tjera aksesore, siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Sa i përket pikës III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi duke iu referuar nenit 262 të LPK-së ku është përcaktuar tërheqja e padisë, e që në rastin konkret i padituri nuk e ka kundërshtuar tërheqjen e padisë.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën II të dispozitivit, u muar sipas nenit 449 dhe 452 par. 1 të LPK-së, me ç‘rast paditësve iu pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 1,182.00.€. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 60.00.-€ (e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), për përpilimin e padisë shuma prej 312.00.-€, për përfaqësimin e të autorizuarit të paditësve në dy seanca shumë prej nga 405.00.-€, apo për të dy seancat shumë e përgjithshme prej 810.00.-€ të parapara sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës Nr. Tarifor 6 dhe 7). Gjukata nuk ia njohi të autorizuarit të paditësve shumë prej 312.00.-€ në emër të përpilimit të parashtrësës për precizimin e kërkesëpadisë, pasi që një precizim të tillë i njëjti ka mundur që ta bëjë edhe në seancë.

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.1007/21, datë 02 Nëntor 2022

Gj y q t a r j a,  
Mirjeta Shala



**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita vijuese pas ditës së pranimi të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate.